



Periodiku AMF

Zhvillohet Mbledhja e Grupit të Punës së Sigurimeve dhe Nënkomitetit të Çështjeve Ndër-sektoriale të IAIS-it

IAIS (Organizata Ndërkombëtare e Mbkëqyrësve në Sigurime) në bashkëpunim me NAIC (Shoqata Kombëtare e Komisionerëve në Sigurime në SHBA), zhvilluan gjatë periudhës 7-9 shtator 2010, në Washington, SHBA, Mbledhjen e Grupit të Punës së Sigurimeve dhe Nënkomitetit të Çështjeve Ndërsektoriale të IAIS-it. Në këtë mbledhje AMF u përfaqësua nga Znj. Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF-së.

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - gusht 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - gusht 2010 arritën shifrën 5,497,047 mijë lekë, përkundrejt 5,478,806 mijë lekë të realizuara në janar - gusht 2009 ose 0.33% më shumë.

Vijon në faqen 3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet Forumi Financiar EUROFI 2010

Gjatë periudhës 27-30 shtator, EUROFI zhvilloi në Bruksel, Belgjikë, Forumin Financiar 2010. EUROFI është krijuar në vitin 2000 si një platformë kryesore për shkëmbimet midis shërbimeve të industrisë financiare dhe autoriteteve publike në çështjet rregullatore dhe të mbikëqyrjes.

Vijon në faqen 5

Zhvillohet Konferenca mbi perspektivat në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve në rajonin e Ballkanit

Byroja Kombëtare e Sigurimeve dhe Agjencia e Mbkëqyrjes së Sigurimeve (ISA), Maqedoni, zhvilluan gjatë periudhës 6-8 tetor 2010, në Ohër, Maqedoni, Konferencën mbi perspektivat në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve në rajonin e Ballkanit.

Vijon në faqen 6

Zhvillohet seminari “Komuniteti i Praktikës për Raportimin Financiar”

Qendra për Reformën e Raportimit Financiar pranë Bankës Botërore, në kuadër të projektit REPARIS (Rruga për në Evropë: Programi i Reformës së Kontabilitetit dhe fuqizimit Institucional) zhvilloi gjatë periudhës 13 - 14 shtator, në Vjenë, seminarin “Komuniteti i Praktikës për Raportimin Financiar”.

Vijon në faqen 7

Zhvillohet seminari “Ofertat Publike dhe Raportimi - Rregullimi i tregjeve përmes kërkesave për Raportim”

Komisioni i Letrave me Vlerë (SEC) dhe Bordi i Tregjeve të Kapitali në Turqi, zhvilluan gjatë periudhës , 21-24 Shtator 2010, Stamboll, Turqi, seminarin me temë "Ofertat Publike dhe Raportimi - Rregullimi i tregjeve përmes kërkesave për Raportim”.

Vijon në faqen 8

Edukimi i konsumatorit

Administrimi dhe mbikëqyrja e risqeve në sistemet e pensioneve me kontribute të përcaktuara

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) tetor 2010)

I. Hyrje

1. Pensionet me kontribute të përcaktuara janë skema në të cilat kontributet që futen në fond janë të paracaktuara, ndërsa pagesat (përfitimet) që jep fondi nuk janë të paracaktuara. Kontributet i paguajnë individët anëtarë dhe/ose punëdhënësit në emër të tyre (në rastin e fondeve të pensioneve të punës me kontribute të përcaktuara) dhe investohen për të akumuluar një tepëriç në kohën e daljes në pension, e cila, më pas, tërhiqet ose përdoret për të blerë një produkt pensioni (siç janë pagesat e rregullta vjetore).

Vijon në faqen 9

Në këtë numër:

Zhvillohet Mbledhja e Grupit të Punës së Sigurimeve dhe Nënkomitetit të Çështjeve Ndër-sektoriale të IAIS-it

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

5

Edukimi i konsumatorit

9

Zhvillohet Mbledhja e Grupit të Punës së Sigurimeve dhe Nënkomitetit të Çështjeve Ndërsektoriale të IAIS-it

IAIS (Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime) në bashkëpunim me NAIC (Shoqata Kombëtare e Komisionerëve në Sigurime në SHBA), zhvilluan gjatë periudhës 7-9 shtator 2010, në Washington, SHBA, Mbledhjen e Grupit të Punës së Sigurimeve dhe Nënkomitetit të Çështjeve Ndërsektoriale të IAIS-it. Në këtë mbledhje AMF u përfaqësua nga Znj. Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF-së.

Anëtarë e pjesëmarrës të kësaj mbledhje, prezantuan zhvillimet e ndodhura në juridiksionet e tyre, në lidhje me mbikëqyrjen e grupeve financiare. Në vazhdim, çështjet e trajtuara në Mbledhjen e Nënkomitetit të Çështjeve Ndërsektoriale kishin të bënin me disa standarde të IAIS-it. Diskutimet u përqendruan rreth standardeve të mëposhtme:

- Diskutim mbi standardet e kërkesave rregullatore të Grupeve Financiare (GSF) dhe Udhëzuesi

Shumë shoqëri të sigurimit veprojnë në formën e grupeve dhe/ose nëngrupeve financiare konglomerate dhe kjo sjell sfida unike mbikëqyrëse, duke përfshirë edhe ato që dalin nga natyra e ndryshme e rregullave në të gjithë sektorët financiarë. Edhe pse ky udhëzim nuk i përket direkt kësaj çështje, GSF siguron një strukturë bazë, duke marrë parasysh praktika të ndryshme mbikëqyrëse në mbikëqyrjen e grupit, duke kontribuar në një mbikëqyrje sa më efektive të nëngrupit të sigurimit brenda konglomeratit financiar. Duhet të theksohet se IAIS është duke zhvilluar një udhëzues të veçantë mbi konglomeratet financiare dhe mbikëqyrjen ndërsektoriale.

- Diskutimi mbi standardin mbi qëllimin e grupit, kompetencat mbikëqyrëse dhe autoriteti juridik

Ky standard ka të bëjë me identifikimin e objektit

të grupit si subjekt i mbikëqyrjes me kompetencat e mbikëqyrësit dhe autoritetin juridik të mbikëqyrësve të përfshirë në mbikëqyrjen e Grupit. Një grup në përgjithësi ekziston kur ka dy ose më shumë ente ku të paktën njëri ka pjesëmarrje influencuese në një sigurues. Gjithashtu, mbikëqyrësi duhet të ketë kompetenca mbikëqyrëse dhe mbrojtje juridike në mënyrë që të ushtrojë mbikëqyrje mbi grupin. Për këtë arsye legjislacioni i vendeve duhet të përcaktojë qartë dhe në mënyrë të mjaftueshme kompetencat juridike të autoriteteve për të ushtruar mbikëqyrje.

- Diskutimi mbi standardin mbi shkëmbimin e informacionit

Shkëmbimi i informacionit, bashkëpunimi dhe koordinimi me të tjerë mbikëqyrës është shumë i rëndësishëm dhe i nënshtrohet kërkesave të konfidencialitetit.

Mbikëqyrësit, në lidhje me shkëmbimin e informacionit, bëjnë marrëveshje të tilla, si memorandume shumëpalëshe të mirëkuptimit IAIS (MMoU) apo memorandume dypalëshe të mirëkuptimit (MM), mbi bazën e të cilave mbikëqyrësi mund ta përdori informacionin apo ta shkëmbejë atë me mbikëqyrës të tjerë duke e trajtuar si konfidencial.

- Diskutimi mbi standardin mbi bashkëpunimin dhe koordinimin mbikëqyrës

U theksua se mbikëqyrësi shkëmben, bashkëpunon dhe koordinon me mbikëqyrës të tjerë duke ju nënshtrohet kërkesave të konfidencialitetit. Në kuadrin e mbikëqyrjes së grupit lind domosdoshmëria për nënshkrimin e marrëveshje midis mbikëqyrësve të përfshirë në çështje ndërkufitare. Mbikëqyrësit e sigurimeve bashkëpunojnë me mbikëqyrësit e sektorëve të tjerë, si bankat qendrore apo strukturat qeveritare të caktuara.

Me rëndësi ishte prezantimi i përfaqësuesit të IMF-së mbi çështjet e sipërpërmendura.

Gjatë zhvillimit të mbledhjes u diskutua edhe plani mbi iniciativën e NAIC-USA për modernizimin e aftësisë paguese në SHBA.

Rregullorja e re e aftësisë paguese është një ekzaminim dhe korrigjon apo përfshin një përmbledhje të zhvillimeve ndërkombëtare lidhur me mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve, mbikëqyrjen bankare, si dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe përdorimin e tyre të mundshëm në rregullimin e industrisë së sigurimit në SHBA. Qëllimi i kësaj iniciative është të përfshijë të gjithë sistemin financiar rregullator të SHBA-së dhe aspektet që lidhen me gjendjen financiare të një siguresi.


Një çështje me rëndësi ishte diskutimi mbi një rishikim të ICP - principeve bazë të sigurimit, si dhe diskutimi mbi një rifreskim të fjalorit unifikues të IAIS-it (IAIS glosary).

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - gusht 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - gusht 2010 arritën shifrën 5,497,047 mijë lekë, përkundrejt 5,478,806 mijë lekë të realizuara në janar - gusht 2009 ose 0.33% më shumë. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 47.20% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 52.80% të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 13.22% të sigurimeve të Jetës dhe një ulje 0.23% të sigurimeve të Jo-Jetës. 89.72% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 9.6% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës dhe 0.69% nga veprimtaria risigurimit.

Gjatë periudhës janar - gusht 2010 u nënshkruan rreth 461,792 kontrata sigurimi, ose rreth 12.55% më pak se në janar - gusht të vitit 2009.



Volumi i primit të shkruar bruto, janar-gusht (2009-2010)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
Janar - Gusht	2009	2010
A) Sigurim i Jetës	465,853	527,442
B) Sigurim i Jo-Jetës	4,943,091	4,931,677
a) Sigurimi Detyrueshëm	2,959,800	2,902,531
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	1,983,290	2,029,146
c) Risigurimi	69,862	37,928
TOTAL	5,478,806	5,497,047

Sigurimet e detyrueshme

Gjatë janar - gusht 2010, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 52.80% të të ardhurave nga primit e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar - gusht 2010, arritën 2,020,798 mijë lekë, ose 6.01% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2009.

Në janar - gusht 2010, primit e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 566,510 mijë lekë, ose rreth 25.61% më pak se në janar - gusht 2009.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar - gusht 2010 arritën në 315,223 mijë lekë, apo 7.95% më shumë se në janar - gusht 2009.

Sigurimet vullnetare

Në janar - gusht 2010, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 2,594,516 mijë lekë (përfshi dhe primit nga risigurimi), ose 3% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë. Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura



2,067,074 mijë lekë (përfshi dhe primit nga risigurimi), vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 32.45%, të pasuara nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 19.61% dhe nga sigurimi kasko me 19.52%. Peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurimet e garancisë, si dhe prime nga veprimtaria e risigurimit.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar - gusht 2010, arritën në 267,361 mijë lekë, 2.56% më pak se në janar - gusht 2009. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 75.64% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në janar - gusht 2010 arritën në rreth 527,442 mijë lekë, ose rreth 13.22% më shumë se në janar - gusht 2009. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 30.27% të primeve.



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 55.63% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - gusht 2010 kapi vlerën 1,292,204 mijë lekë, ose 24.59% më shumë se në janar - gusht 2009. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 1,124,450 mijë lekë, apo 87.02% të totalit.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet Forumi Financiar EUROFI 2010

Gjatë periudhës 27-30 shtator, EUROFI zhvilloi në Bruksel, Belgjikë, Forumin Financiar 2010. EUROFI është krijuar në vitin 2000 si një platformë kryesore për shkëmbimet midis shërbimeve të industrisë financiare dhe autoriteteve publike në çështjet rregulatore dhe të mbikëqyrjes. EUROFI, është një organizatë jofitimprurëse dhe anëtarët e saj janë institucione financiare evropiane të masave të ndryshme (vendase dhe përtej kufijve), të sektorëve të ndryshëm të industrisë (të përgjithshëm dhe të specializuar, banka shoqëri sigurimesh), si dhe me statuse të ndryshme (tregtare, kooperativa apo mutual).

EUROFI, vepron si një katalizator për tregun duke lidhur aktorë të ndryshëm të industrisë së financave me autoritetet publike.

Çdo vit, EUROFI organizon Forumin Ndërkombëtar Financiar, i cili është një mundësi për drejtuesit e industrisë, anëtarët dhe partnerët e EUROFI, dhe vendimmarrësit e vendeve të BE-së ose jo, të ndërveprojnë në mënyrë joformale dhe të marrin pjesë në diskutime të nivelit të lartë rreth çështjeve të rregullatorëve dhe industrisë.

Forum i këtij viti u fokusua mbi sfidat e reja të integritimit Evropian si pasojë e globalizimit dhe krizës financiare: proceset rregulatore, politika e një tregu të vetëm, politikat fiskale të BE-së, pagesat dhe infrastruktura e tregut të titujve.

Në Forum morën pjesë vendimmarrës nga Komisioni dhe Parlamenti Evropian, Banka Evropiane Qendrore, rregullatorë, si dhe mjaft drejtues nga bankat, tregu i sigurimeve. Forumi u përshëndet nga Presidenti i Komisionit Evropian Jose Manuel Barroso.

Qëllimi i forumit ishte diskutimi mbi prioritetet e mbikëqyrjes financiare, si dhe rregullat që nevojiten për forcimin më tej të stabilitetit financiar dhe rritjes

ekonomike. Në forum ishin të ftuar dhe përdorues të tregut financiar evropian (emetues, biznese, konsumatorë).

Gjatë ditës së parë të forumit, diskutimet u përqendruan në prioritetet e Presidencës së Belgjikës të BE-së, për fushën e shërbimeve financiare, ashtu si dhe u diskutua mbi axhendën legjislative të Komisionit të BE-së.

Nga diskutimet doli nevoja për të përcaktuar një plan të ri aksioni evropian si: rishikim të MiFiD (direktiva e instrumentave financiarë të tregut), zbatimi i një zone pagese të vetme Euro (SEPA), masat për zbatimin e Solvency 2, rishikimi i direktivës së fondeve të pensioneve, organizimi i tregjeve të derivativeve, mbrojtja konsumatore, etj. Po ashtu, u diskutua për të planifikuar ndryshime specifike rregullatore lidhur me tregjet dhe infrastrukturën paguese, përta i përket atyre që lidhen me institucione financiare të ndryshme si: administratorë të fondeve, fondet e pensionit, siguruesit, bankat e investimeve në nivel kombëtar dhe jashtë kufijve të BE-së.

Në ditët në vijim, diskutimet u fokusuan në përcaktimin e bazës për një rregullator dhe mbikëqyrës të përbashkët Evropian, në mënyrë që të arrihet fleksibilitet, rritje dhe konkurrencë në tregjet financiare.

Forumi u mbyll me diskutimin e prioritetëve për diskutim në takimin e G20, që do të mbahet në Seul-Kore si: sfidat që imponohen nga zbatimi i kuadrit të ri rregullator dhe mbikëqyrës në kontekstin global, roli i mbikëqyrësit për të mbështetur zbatimin e kërkesave të reja të mbikëqyrjes, kuadri rregullator për menaxhimin e krizës, etj.

Zhvillohet Konferenca mbi perspektivat në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve në rajonin e Ballkanit

Byroja Kombëtare e Sigurimeve dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (ISA), Maqedoni,

zhvilluan gjatë periudhës 6-8 tetor 2010, në Ohër, Maqedoni, Konferencën mbi perspektivat në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve në rajonin e Ballkanit.

Në ditën e parë të saj konferencën e përshëndeti përfaqësuesi i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë Z. Klime Popovski, dhe i Byrosë së Maqedonisë Z. Jonce Popovski, të cilët bënë një ekspozitë të tregut të sigurimeve në Maqedoni, të perspektivës së zhvillimit të tij, si dhe shpallën strategjinë e tyre në këtë fushë. Konferencën e përshëndeti dhe përfaqësuesi i Këshillit të Byrove dhe përfaqësuesi i Shoqatës së Siguruesve të Austrisë.

Në ditët në vijim diskutimet u fokusuan në domosdoshmërinë e gjetjes së rrugëve të reja për rritjen e nivelit të sigurimeve dhe veçanërisht atyre vullnetare, të sigurimit të jetës dhe sidomos të sigurimit të detyrueshëm, problemet e kartonit jeshil në rajonin e Evropës, si dhe mënyrës së analizimit të tarifave të policave të sigurimit.

Në këtë konferencë, përfaqësuesi i AMF-së mbajti prezantimin me temë: "Politika e çmimit unik dhe liberalizimi i tregut të sigurimit të detyrueshëm, MTPL". Prezantimi i AMF-së i vlerësuar edhe nga pjesëmarrësit, paraqiti një panoramë të situatës aktuale të tregut të sigurimeve MTPL dhe strategjinë për realizimin e procesit të plotë të liberalizimit në Shqipëri.

Pjesëmarrja në këtë konferencë i shërbeu shkëmbimit të eksperiencave, të informacionit apo të pikëpamjeve, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të tregut të sigurimeve, sidomos të tregut të sigurimit të detyrueshëm, forcimit të bashkëpunimit të vendeve të rajonit në fushën e sigurimit, zhvillimit dhe zbatimit të Direktivave të BE-së e standardeve ndërkombëtare të mbikëqyrjes, etj.

Në Konferencë, morën pjesë përfaqësues nga autoritetet mbikëqyrëse e shoqëritë e sigurimit të Maqedonisë, Sllovenisë, Bullgarisë, Kroacisë,



Serbisë, Kosovës, Malit të Zi, Austrisë e Gjermanisë, si dhe gjyqtarë të Gjykatës së Lartë e të Apelit të Maqedonisë.

Zhvillohet seminari “Komuniteti i Praktikës për Raportimin Financiar”

Qendra për Reformën e Raportimit Financiar pranë Bankës Botërore, në kuadër të projektit REPARIS (Rruga për në Evropë: Programi i Reformës së Kontabilitetit dhe fuqizimit Institucional) zhvilloi gjatë periudhës 13 - 14 shtator, në Vjenë, seminarin “Komuniteti i Praktikës për Raportimin Financiar”.

REPARIS është një program rajonal, i cili ka për qëllim krijimin e një ambienti të politikave transparente dhe të një kornize institucionale efektive për raportimin e korporatave në Evropën Juglindore dhe Jugqendrore. Vendet pjesëmarrëse të këtij programi janë: Shqipëria, Bosnja&Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi dhe Serbia.

Objektivat e seminarit ishin ndihmesa e ekonomive REPARIS në:

- përafrimin e ligjeve të tyre të kontabilitetit dhe kërkesave të tjera, të lidhura me bazën ligjore të Komunitetit Evropian;
- zgjedhjen e kërkesave të duhura për raportimin financiar, për forma dhe madhësi të ndryshme të njësive ekonomike brenda kornizës së bazës ligjore të Komunitetit Evropian;
- të kuptuarin e parimeve në përgatitjen dhe prezantimin e IFRS (SNRF) për SME ((NMV) (në terma të madhësisë)).

Gjatë ditës së parë të seminarit, pjesëmarrësit u përqendruan në zbatimin e bazës ligjore të Komunitetit Evropian. Zbatimi i saj në fushën e kontabilitetit dhe çështjeve të lidhura me to, përbën një sfidë për të gjitha ekonomitë REPARIS. Një ndër problemet kryesore që doli nga diskutimi i pjesëmarrësve gjatë ditës së parë të

seminarit, ishte sfida që konsiston në faktin se struktura e këtyre ekonomive është mjaft e ndryshme nga struktura e ekonomive të vendeve të Bashkimit Evropian.

Niveli aktual i detyrimeve për raportim financiar të shoqërive (standardet kontabël që aplikohen, kufiri për NMV (në terma të madhësisë), kërkesat për auditim dhe publikim të pasqyrave financiare në ekonomitë REPARIS, u rishikuan nën dritën e Direktivave 4 dhe 7 të Bashkimit Evropian, nga të cilat u analizuan katër elementë të rëndësishëm, të cilët duhet të kihet parasysh gjatë përafrimit të legjislacionit aktual me këto direktiva:

- standardet kontabël të aplikuara;
- kufiri (limiti) për përcaktimin e detyrimeve kontabël;
- kufiri (limiti) për përcaktimin e detyrimeve për auditim;
- kërkesat për publikimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të auditimit.

Direktivat 4 dhe 7, në fillimet e tyre, janë hartuar për shoqëritë e mëdha, por që nga viti 2005, shoqëritë e listuara dhe ato me përgjegjësi publike (bankat, shoqëritë e sigurimeve, fondet e pensioneve, etj.) kanë aplikuar SNRF-të. Grupi kryesor i synuar janë NMV-të, si rrjedhim, këto direktiva kanë nevojë për rishikim pasi ato përbëjnë një barrë administrative për shoqëritë e vogla.

Dy propozimet e ngritura nga Komisioni Evropian, qenë:

- mundësia për të përjashtuar shoqëritë mikro nga Direktivat Kontabël dhe;
- rishikimi i kërkesave të Direktivave për shoqëritë e vogla (diskutimi për këtë çështje konsiston në përafrimin/konvergimin e Direktivave më kërkesat e SNFR për NMV - aktualisht ka gjashtë ndryshime mes këtyre dy trajtimeve kontabël).

Lidhur me limitet, për klasifikimet e shoqërive,

sipas Bashkimit Evropian, Kroacia është i vetmi vend mes ekonomive REPARIS që ka adaptuar këto limite për klasifikimin e shoqërive, limitet (kufijtë) e vendosura nga Mali i Zi janë në kundërshtim me limitet Evropiane, ndërkohë që vendet e tjera kanë kufij më të ulët se ato të Bashkimit Evropian, nga ku Shqipëria ka kufirin më të ulët për klasifikimin e shoqërive të vogla (< 350,000 euro).

Diskutimi mbi përafrimin me direktivat u zgjerua më tej në përfitimet dhe kostot që mund të shoqërojnë këtë proces në ekonominë REPARIS. Nga pjesëmarrësit u ngrit shqetësimi që, nëse përdoren limitet (kufijtë) evropiane për klasifikimin e shoqërive, për shkak të strukturës aktuale të ekonomive REPARIS, mbi 90% e shoqërive do të klasifikoheshin si mikro shoqëri dhe si të tilla nuk do të kishin detyrime për mbajtje të kontabilitetit (llogarive kontabël vjetore dhe përgatitje të pasqyrave kontabël). Kjo do të shoqërohej më uljen e transparencës dhe rritjen e informalitetit, ndërkohë që do kishte ulje të kostove për shoqëritë.

Konkluzionet e diskutimit mbi përafrimin me bazën ligjore të Komunitetit Evropian, si dhe zhvillimet e mundshme, qenë:

- aplikim i SNRF-ve të plota për shoqëritë e listuara dhe ato me përgjegjësi publike;
- Direktivat e Kontabilitetit mbeten baza për shoqëritë e palistuar;
- thjeshtim i Direktivave, reduktim i barrës sidomos për shoqëritë e vogla.

SNRF për NMV ishin tematika e diskutuara gjatë ditës së dytë të seminarit. Prezantuesit (ish-anëtarë të Bordit të SNK) u përqendruan në disa nga çështjet kryesore të SNRF për NMV. Prezantimet e tyre konsistuan në aspekte teorike, shoqëruar dhe me raste/shembuj praktikë të çështjeve të mëposhtme:

- prezantimi i Pasqyrave Financiare sipas SNRF për NMV (Pasqyra e pozicionit financiar,

pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të parave, si dhe shënimet e pasqyrave);

- prezantimi i pasqyrave financiare sipas SNRF për NMV (Të ardhurat);
- prezantimi i pasqyrave financiare sipas SNRF për NMV (politikat kontabël, vlerësimet dhe gabimet, efektet e normave të këmbimit, ngjarjet pas datës së bilancit, dhe marrëdhëniet me palët e lidhura).

Në përfundim të seminarit nga të pranishmit u dhanë ide të ndryshme në lidhje me tematikat e ardhshme si: diskutim i draft ligjit kosovar për kontabilitetin, diskutim i ligjeve serbe dhe malazeze për kontabilitetin (meqenëse në këto vende priteshin ndryshime në aspektin ligjor), vazhdimi i trajnimeve në fushën e aplikimit të SNRF-ve, etj.

Zhvillohet seminari “Ofertat Publike dhe Raportimi - Rregullimi i tregjeve përmes kërkesave për Raportim”

Komisioni i Letrave me Vlerë (SEC) dhe Bordi i Tregjeve të Kapitalit në Turqi, zhvilluan gjatë periudhës, 21-24 Shtator 2010, Stamboll, Turqi, seminarin me temë "Ofertat Publike dhe Raportimi - Rregullimi i tregjeve përmes kërkesave për Raportim".

Programi tre ditor shërbeu si një forum për shkëmbimin e praktikave më të mira për zhvillimin dhe rregullimin e tregjeve transparente të kapitalit, prezantuar nëpërmjet leksioneve, tryezave të rrumbullakëta dhe rasteve studimore. Ekspertë të fushës ndanë mendimet e tyre në lidhje me promovimin e transparencës dhe të raportimit si një mjet për rregullimin e tregjeve të kapitalit. Gjithashtu programi eksploroj reagimet ndaj shkeljeve dhe mashtrimeve në raportime dhe krahasoi metodat e ndryshme të sistemeve rregullatore në mbarë botën duke nënvizuar praktikën më të mira ndërkombëtare.

Ndër temat që u diskutuan gjatë këtij seminari, përmendim:

- rëndësinë e rregulloreve me bazë mënyrat dhe kushtet e raportimit të kompanive me ofertë publike. Tema u fokusua në procesin e një oferte publike fillestare, procesin e nënshkrimit të aksioneve në rolin që rregullatori i letrave me vlerë kishte në këtë proces dhe përfitimet që ofertat publike fillestare (IPO's) u sjellin ekonomive, investitorëve dhe kompanive. Gjithashtu u listuan detyrimet e këtyre shoqërive për të raportuar në momentin fillestar të ofertës publike, me qëllim informimin e investitorit, si dhe detyrimet për të raportuar mbas saj, përmes raportimeve periodike, vjetore dhe raportimeve të ngjarjeve materiale. Gjithashtu u shqyrtuan tendencat globale të ofertave publike fillestare ku u përmendën ofertat më të mëdha publike në histori, ofertat publike të tregjeve në zhvillim, tarifatat e nënshkrimit të aksioneve, si dhe u trajtua rasti studimor i ofertës publike të General Motors.
- standardet e listimit në bursa, avantazhet e listimit, listimet e dyfishta, sfidat e SME-ve për të arritur financim, metodat rregullatore për SME-të, bursat e SME-ve dhe arsyet e dështimit të tyre .
- kuadrin e kontabilitetit për shoqëritë emetuese të aksioneve duke u fokusuar në rolin që SEC ka luajtur në vendosjen e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, si dhe në adaptimin e një sistemi kontabiliteti 'principle-based'. Gjithashtu u diskutua roli i veçantë që 'Organizata Ndërkombëtare e Komisionit të Letrave me Vlerë' (IOSCO) ka luajtur në krijimin e një raportimi dhe kontabiliteti ndërkombëtar me krijimin e bazës së të dhënave të SNRF-ve, si dhe roli i auditimit në raportimin financiar duke theksuar rëndësinë e ekspertëve dhe auditorëve të pavarur.
- investigimin në Mashtrimin Financiar, shkeljet

e tjera në raportim dhe mundësitë e ndryshme për ndreqjen e tyre. U trajtuan skemat tipike të mashtrimit financiar, evidencat e mashtrimit në të dhënat financiare, rolin që kontrollet e brendshme kanë në qeverisjen e shoqërisë për parandalimin e mashtrimeve financiare, si dhe rolin e ekspertëve dhe auditorëve të pavarur. Gjithashtu, u trajtuan raste të ndryshme studimore të kompanive me të njohura të përfshira në mashtrim, pasojat e këtyre mashtrimeve, si dhe pyetjet më tipike që bëhen gjatë një investigimi për të dalluar mashtrimin.

- marrëdhëniet me palët e lidhura, kërkesat rregullatore për të raportuar këto transaksione, si dhe çështjet e ndryshimeve në pronësi gjatë shkrirjeve dhe bashkimeve të kompanive.
- rëndësinë e qeverisjes së korporatës , si dhe çështje të tilla si: kompensimi i menaxhimit të lartë, përbërja e bordit të drejtorëve dhe pavarësia e tyre, të drejtat e aksionarëve të korporatës, si dhe roli i qeverisjes së shoqërisë në bizneset familjare.

Edukimi i konsumatorit

Administrimi dhe mbikëqyrja e risqeve në sistemet e pensioneve me kontribute të përcaktuara

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) tetor 2010)

I. Hyrje

1. Pensionet me kontribute të përcaktuara janë skema në të cilat kontributet që futen në fond janë të përcaktuara, ndërsa pagesat (përfitimet) që jep fondi nuk janë të përcaktuara. Kontributet i paguajnë individët anëtarë dhe/ose punëdhënësit në emër të tyre (në rastin e fondeve të pensioneve profesionale me kontribute të përcaktuara) dhe investohen për të akumuluar një tepriçë në kohën e daljes në pension, e cila, më pas, tërhiqet ose përdoret për

të blerë një produkt pensioni (siç janë pagesat e rregullta vjetore).

2. Termi “kontribute të përcaktuara” përdoret për një gamë të gjerë skemash në mbarë botën, që nga skemat “e pastra me kontribute të përcaktuara” ku pagesat e anëtarëve vijnë tërësisht nga kontributet plus kthimi nga investimi, deri te skemat ku garantohet një nivel minimal pagese.¹ Krahas kësaj, sistemet me kontribute të përcaktuara në mbarë botën ndryshojnë në varësi të faktit nëse janë menduar apo jo të jenë një burim kryesor të ardhurash pensioni (domethënë, në varësi të raportit që kanë me sistemin e pensioneve publike), shkallës në të cilën janë të detyrueshme këto skema dhe shkallës me të cilën mund ta zgjedhë konsumatori skemën, në varësi të konkurrencës së tregut brenda sistemit.

3. Mbikëqyrja e këtyre skemave të pensioneve me kontribute të përcaktuara, po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, për disa arsye. Së pari, duke qenë se jetëgjatësia (mosha mesatare e popullsisë) i ka rritur kostot për qeveritë dhe punëdhënësit, të lidhura me ofrimin e pensioneve, sistemet e pensioneve “pay as you go” dhe sistemet e pensioneve me përfitime të përcaktuara po plotësohen ose po zëvendësohen nga skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara.²

4. Krahas kësaj, çështjes së mënyrës së administrimit të riskut dhe mbikëqyrjes së pensioneve me kontribute të përcaktuara i është rritur rëndësia për shkak të krizës financiare të vitit 2008-2009, e cila pati një efekt drastik në disa sisteme me kontribute të përcaktuara, të cilat pësuan humbje të investimeve deri në 20-30% (rëniet më të mëdha erdhën nga ato portofole që kishin zbulim të madh kapitali neto). Rënia e vlerës së kursimeve për pensionet është shqetësimi më i madh për punonjësit që janë pranë moshës së daljes në pension, si edhe për ata që janë në fazën e përfitimit të pagesave por që nuk kanë kaluar në portofole konservativë apo që nuk kanë blerë pagesa të rregullta vjetore.

Megjithatë, rëniet e një shkalle të tillë kanë pasur efektin e tyre në besimin e përgjithshëm në sistemet me kontribute të përcaktuara.

5. Shumë sisteme me kontribute të përcaktuara janë ende relativisht të reja³ dhe në shumë vende ka shumë pak persona që kanë dalë në pension kryesisht nga skema me kontribute të përcaktuara. Megjithatë, mbikëqyrja e sistemeve me kontribute të përcaktuara bëhet edhe më e rëndësishme me zhvillimin dhe maturimin e këtyre sistemeve dhe autoritetet mbikëqyrëse, për rrjedhojë, bëjnë pyetjen nëse duhet ndryshuar apo jo qasja mbikëqyrëse e tyre me futjen në përdorim të këtyre skemave, dhe, nëse po, si duhet ndryshuar kjo qasje? Me përshtatjen gjithnjë e më shumë të qasjes mbikëqyrëse nga autoritetet mbikëqyrëse, lind edhe pyetja se si duhen zbatuar këto teknika për pensionet me kontribute të përcaktuara? Duke pasur parasysh se risqet brenda skemave me kontribute të përcaktuara mbahen nga palë të tjera nga ato që mbajnë risqet në skemat me përfitime të përcaktuara (domethënë, risqet e punëdhënësve zëvendësohen nga risqet e anëtarëve), entet mbikëqyrëse ngrenë pyetjen nëse janë të nevojshme apo jo teknika të tjera mbikëqyrëse. Për më tepër, llojet e ndryshme të sistemeve me kontribute të përcaktuara a kanë nevojë për lloje të ndryshme kontrolli mbikëqyrës?

6. Pjesa më e madhe e literaturës për pensionet është përqendruar historikisht te skemat me pagesa të përcaktuara, duke lënë kështu një boshllëk që duhet mbushur. Kështu, ky material përpiket të paraqesë disa prej çështjeve të ndryshme me të cilat përballen entet mbikëqyrëse të pensioneve në mbikëqyrjen e

¹ Këto skema mbulohen nga rregullimi i pensioneve me pagesa të përcaktuara, në disa vende.

² Kështu ndodh edhe në bastionet tradicionale të skemave me përfitime të përcaktuara, siç janë Vendet e Ulta, ku skemat hibride si ato me kontribute të përcaktuara kolektive, po hasen gjithnjë e më shumë.

³ Australia dhe Kili janë dy përjashtime dhe, për rrjedhojë, janë raste studimore interesante për t'u parë nga afër.

sistemeve të pensioneve të mbështetura në kontributet e përcaktuara. Thelbi i mbikëqyrjes së pensioneve me kontribute të përcaktuara është se risqet brenda këtyre sistemeve mbahen nga individët. Kështu që në material skicohen mekanizmat e ndryshme të mbrojtjes së individëve dhe zbutja e këtyre risqeve, krahas diskutimit se si e prekin qasjen mbikëqyrëse mekanizmat e ndryshme të kontrollit. Në fund, jepen raste studimore të hollësishme të një vargu autoritetesh anëtare të IOPS-it të cilat mbikëqyrin sisteme pensionesh me kontribute të përcaktuara.

7. Edhe pse materiali mbështetet te parimet e IOPS-it dhe OECD-së, sipas rastit, ai është menduar të jetë përshkrues dhe jo normativ, kështu që ka si synim të plotësojë udhëzimet për praktikën e mirë, të cilat gjenden në publikimet përkatëse të IOPS-it.

II. Çfarë ndryshon në sistemet e pensioneve me kontribute të përcaktuara?

8. Dallimi kryesor midis skemave me kontribute të përcaktuara dhe formave të tjera të skemave të pensioneve është se risqet e skemës i mbajnë në përgjithësi anëtarët individualë.⁴ Këto risqe përfshijnë riskun e investimit, të riskun operativ, etj. Risqe të tilla janë të pranishme edhe në skemat me përfitime të përcaktuara, por në rastin e produkteve të përfitimeve të përcaktuara apo produkteve të siguruar, ka një palë tjetër (siç është ai që paguan kontributin apo ofruesi i skemës) që kompenson deficionin e shkaktuar nga humbjet e investimeve, jetëgjatësia më e madhe, apo për të mbuluar tarifat dhe kostot që lindin nga gabimet administrative. Në skemat me kontribute të përcaktuara, të gjithë këta faktorë ndikojnë në “tepricën” e llogarisë së akumuluar nga e cila secili anëtar individual duhet të mbulojë pensionin, çka e rrit riskun themelor të një sistemi me kontribute të përcaktuara (personat dalin në pension pa një pension të mjaftueshëm dhe të sigurt).⁵

9. Në skemat me përfitime të përcaktuara, fokusi i entit mbikëqyrës është të sigurohet se paguesi i kontributeve jep fonde të mjaftueshme për skemën për të siguruar dhënien e pensionit të premtuar. Risku i investimit, risku i jetëgjatësisë, inflacioni, etj., merren të gjithë në konsideratë gjatë vlerësimit të aftësisë paguese të fondit apo skemës. Qasja mbikëqyrëse, për pasojë, përqendrohet te çështjet e financimit apo të aftësisë paguese, duke shikuar hipotezat dhe shpesh duke testuar për të parë nëse ka të ngjarë apo jo që pensionet e premtuara të paguhen në rast të rrethanave jo të favorshme. Në sistemet me kontribute të përcaktuara fokusi duhet të jetë te proceset dhe jo te rezultatet, duke qenë se pagesat (pensionet) nuk janë të garantuara. Roli i entit mbikëqyrës është të sigurojë që fondi i pensioneve administrohet në mënyrë të sigurt, në njëjtën mënyrë sikur këtë ta bënin vetë anëtarët e planit. Fokusi i entit mbikëqyrës duhet të jetë te risqet që kanë ndikim te vetë anëtarët e fondit dhe të cilat mund të bëjnë që këta anëtarë të humbasin para. Duke qenë se është anëtar i ai që mban riskun, janë rezultatet për anëtarin ato që kërkon të mbrojë enti mbikëqyrës i pensioneve dhe fokusi gjatë shikimit të risqeve është te arritja e rezultateve optimale për anëtarët. Këto rezultate optimale do të përfshinin

⁴ Duhet theksuar se, sikurse përshkruhet më lart, ka lloje të ndryshme skemash me kontribute të përcaktuara dhe se vetëm në formën më të pastër të skemave me kontribute të përcaktuara të gjitha risqet i mbajnë anëtarët e skemës. Për shembull, në rastet ku jepet një garanci investimi (nga ofruesi i skemës, nga një shoqëri sigurimesh apo, madje, nga vetë shteti) një pjesë e riskut të investimit ndahet me palën tjetër. Po kështu, me fondet e pensioneve profesionale me kontribute të përcaktuara, disa prej kostove administrative dhe një pjesë të riskut mund ta mbajë edhe punëdhënësi që paguan kontributet.

⁵ Në rastin e skemave me përfitime të përcaktuara apo në rastin e produktit të siguruar, në të cilat këto risqe i mban ai që i paguan kontributet, ekziston edhe mundësia e paaftësisë paguese e cila mund të prekë të drejtat e anëtarëve individualë, ndërsa në rastin kur risqet e skemave me kontribute të përcaktuara mbahen drejtpërdrejt nga anëtar i ai nuk ka risk të paaftësisë paguese. Ka njëfarë risku të paaftësisë paguese në rastin kur personi që paguan kontributet mbulon edhe kostot administrative ose ofron garanci, por, zakonisht, kjo është shumë më pak e ndjeshme se për pagesat e përcaktuara. Masat që marrin entet mbikëqyrëse për ta trajtuar këtë risk të mbetur të paaftësisë paguese janë të ngjashme me ato që merren në lidhje me risqet e paaftësisë paguese të skemave me pagesa të përcaktuara dhe nuk mbulojnë nga ky material.

vendimet e duhura për kontributet, administrimin e efektshëm, vendimet e duhura për investimet, sigurinë e aktiveve, vendimet e duhura për parapagimin dhe leverdinë.

10. Anëtarët vuajnë nga një risk i mëtejshëm në sistemet me kontribute të përcaktuara ku janë të detyruar të marrin një sërë vendimesh. Ndër këto mund të përfshihen:

- sa kontribut të paguaj;
- në cilin plan të anëtarësohem/cilin ofrues të përdor;
- si të investoj në aktivet e tyre;
- çfarë produkti të blej në moshën e daljes në pension.

11. Studime të shumta tregojnë që këto nuk janë vendime për të cilat shumica e anëtarëve janë të pajisur mirë për t'i marrë, edhe pse regjimi mbikëqyrës kujdeset që t'u jepet informacion i mjaftueshëm për këtë qëllim.⁶ Të tjerë (2009) argumentojnë se kapaciteti i kufizuar i individëve për të zgjedhur se çfarë është më e mira për ata rrjedh nga *“një kombinim i mungesës së edukimit financiar, logjikës së kufizuar dhe përdorimit të rregullave të thjeshtësuara në procesin e vendimmarrjes”*.

Problemet e drejtimit të sistemeve me kontribute të përcaktuara

Atëherë kur vendimet nuk merren drejtpërdrejt nga anëtarët por në emër dhe për llogari të tyre (nga punëdhënësit/personat e besuar etj., siç mund të jetë rasti i skemave të pensioneve profesionale me kontribute të përcaktuara, të cilët veprojnë me detyrimin e besnikërisë) shumë prej çështjeve dhe fokusi mbikëqyrës përsëri ndryshon nga sistemet me përfitime të përcaktuara.

Sistemet me kontribute të përcaktuara të cilat

⁶ Shih (OECD 2008a). Më shumë informacion mund të gjeni përmes projektit të OECD-së për edukimin financiar www.financial-education.org

janë të strukturuar në mënyrë të atillë që individët mbajnë riskun por vendimet i marrin palë e tjera (për shembull, paguesit e kontributeve zgjedhin ofruesit ose mundësitë e investimeve) sjellin sfida të veçanta për autoritetet e mbikëqyrjes së pensioneve.

Kur ekziston njëfarë organi kolektiv me detyrim besnikërie (siç është rasti i shumicës së skemave të pensioneve me kontribute të përcaktuara), i cili merr vendimet në emër dhe për llogari të anëtarëve dhe përfituesve të skemës me kontribute të përcaktuara, mbikëqyrësi mund të fokusohet shumë më shumë te puna për t'u kujdesur që personat që marrin vendimet të veprojnë me të vërtetë për llogari të anëtarëve (sikurse diskutohet më poshtë) dhe që ata të kenë dijenitë e përshtatshme për t'i marrë këto vendime (çka mund të përbëjë një sfidë për “personat e besuar nga populli” të cilët marrin pjesë më bordin e skemave apo fondacioneve jofitimprurëse të pensioneve).

Kur nuk ekziston një organ i tillë mbikëqyrës mund të lindë një “vakum qeverisës”. Janë provuar mënyra të ndryshme për ta mbushur këtë boshllëk të qeverisjes (për shembull, duke futur rregulla të zonës së mbrojtur për të nxitur vendimmarrjen parapritëse në emër dhe për llogari të anëtarëve, duke u kërkuar të tretëve, siç janë audituesit, të veprojnë si “lajmërues të problemeve”, apo duke futur konceptin e qeverisjes me përfaqësim përmes organeve të tilla si komitetet e administrimit). Vetë mbikëqyrësit mund të luajnë një rol më aktiv në rrethana të tilla (për shembull, duke i monitoruar dhe kufizuar investimet).

Kjo çështje nuk diskutohet më tej në këtë material, por është shikuar me hollësi në (Stewart, Yermo 2008), (Byrne e të tjerë 2007).

12. Ky element i zgjedhjes që bëjnë anëtarët, për rrjedhojë, sjell konkurrencën e tregut në sistemet e pensioneve, shkallën me të cilën ndryshon konkurrenca në bazë të shkallës së zgjedhjes që

mund të bëjë vetë anëtari. Ky element i zgjedhjes që bëjnë anëtarët, për rrjedhojë, sjell konkurrencën e tregut në sistemet e pensioneve, shkalla me të cilën ndryshon konkurrenca varet në bazë së zgjedhjes që mund të bëjë vetë anëtari.

Roli i rëndësishëm që luan konkurrenca në disa sisteme me kontribute të përcaktuara dallon nga sistemet me pagesa të përcaktuara ku roli i tregut mund të jetë më i kufizuar.⁷ Për rrjedhojë, ka njëfarë potenciali që skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara të disiplinohen nga tregu, i cili duhet t'i orientojë pjesëmarrësit dhe aktivet në drejtim të skemave të pensioneve të administruara më mirë.

13. Problemi, sikurse e thonë edhe Impavido e të tjerë (2009), është se kapaciteti i kufizuar i individëve për të zgjedhur se çfarë është më e mira për ta do të thotë se konkurrenca dhe tregjet rrallë punojnë në mënyrë të efektshme brenda sistemeve të pensioneve, duke u lënë pushtet të tepruar në duar ofruesve të pensioneve. Problemi ekzagjerohet vetëm atëherë kur ofruesit e pensioneve janë institucione financiare tregtare.⁸ Për rrjedhojë, mund të ketë konflikt interesi midis detyrimit të besnikërisë për të vepruar në interes të anëtarëve dhe përfituesve të fondit të pensioneve dhe nxjerrjes së fitimeve për aksionarët.

⁷ Duke pasur parasysh se, në skemat me pagesa të përcaktuara, punëmarrësit kanë liri të kufizuar zgjedhjeje, janë punëdhënësit dhe bordet e besimit ato që i zgjedhin ofruesit. Konkurrenca është gjithashtu më pak e rëndësishme në rastet kur fondet apo skemat e pensioneve nuk janë operacione tregtare dhe nuk zotërojnë kapital neto apo borxh të tregtuar në bursë (domethënë, nuk kanë instrumente mbi të cilat vepron disiplina e tregut).

⁸ Fondet "jofitimprurëse" mund të manipulohen edhe nga ofruesit/këshilluesit tregtarë (për shkak të hendekut të aftësive). Edhe fondet me përfitime të përcaktuara mund të përdorin ofrues tregtar dhe, për rrjedhojë, edhe ato përballen me problemet e konfliktit, por çdo kosto shtesë që rrjedh nga kjo apo çdo ecuri e dobët e investimeve do të mbulohej nga ai që paguan kontributet në skemë. Problemet konkrete të konfliktit në rastin e skemave me përfitime të përcaktuara, të cilat lindin nga objektivat e ndryshme të paguesit të kontributeve (që është minimizimi i kontributeve) dhe i anëtarëve dhe përfituesve të skemës (që është arritja e një skeme me sa më shumë fonde) nuk trajtohen në këtë material.

14. Ky risk mund të marrë (të paktën) tri forma: një menaxher tregtar ka motivime të tjera të mundshme kundrejt mirëqenies së anëtarëve dhe përfituesve dhe, kështu, mund të marrë vendime që nuk janë në interesin më të mirë të tyre (për shembull, të bëjë shitje të kryqëzuar të produkteve të ndryshme anëtarëve të skemës apo të kërkojë tarifa të larta); kur menaxherët tregtarë apo jofitimprurës nuk administrojnë fondet e tyre dhe nuk mbajnë vetë asnjë risk, u mungojnë stimujt për t'u kushtuar kohën, energjinë dhe idetë e mjaftueshme për të arritur rezultatet më të mira; kur një menaxher jofitimprurës (për shembull, një person i besuar) mund të mos ketë njohuritë e duhura prej eksperti për të parandaluar këshilltarët e motivuar me qëllime tregtare që të mos i bindin ata të veprojnë në mënyra që nuk janë në interesin më të mirë të anëtarëve dhe përfituesve.

15. Nëse nuk mbahet nën kontroll, ky pushtet i tepërt mund të sjellë këto pasoja:

- tarifa me të padrejtë të larta (duke përfshirë edhe ato që vijnë pa të drejtë nga tregtimi i tepërt);
- zgjedhje e shtrembëruar e ofruesve të shërbimeve (për shembull, nga i njëjti grupim) apo i produkteve të investimeve:

 - komisione të fshehura
 - tregtim në kushtet e pasjes së informacionit të privilegjuar
 - (të cilat të gjitha mund të çojnë në) ecuri të dobët të investimeve
 - zbulim ndaj një risku të tepruar të investimit.

16. Po të kemi parasysh kufizimet e tregut si mekanizëm i kontrollit të riskut, roli që luan konkurrenca në sistemet e pensioneve me kontribute të përcaktuara ndryshon nga njëri

sistem në tjetrin. Sistemet që kërkojnë nivele më të larta mbrojtjeje (domethënë, sistemet e detyrueshme) shpesh përdorin një lloj konkurrence të menaxhuar me një numër të kufizuar aktorësh dhe produktesh investimi të mbajtura rreptësisht nën kontroll, etj.

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, V. Theodhori, J. Sokoli,
J. Mele, R. Eltari, Dh. Hazbiu, E. Kokona

